



## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

### DREJTORIA TEKNIKE

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

### Operatorit Ekonomik “InfoSoft Office” shpk

**Adresa:** Tirane Kashar Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti 1: “Materiale kancelarie me bazë letre”, me Nr. REF-13599-07-18-2024** për nevoja të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e parë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marrëveshjes kuader nga autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 40 datë 22 Korrik 2024

Publikimet e mëparshme (njoftimi i fituesit paraprak): Buletini Nr. 69 datë 14 Tetor 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

• **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k**

**NUIS J62426002Q**

Vlera e ofertës pa tvsh = 9,097,759 (nëntë milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k** **NUIS L52122014L**

Vlera e ofertës pa tvsh = 7,130,430 (shtatë milion e njëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k** **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës pa tvsh = 10,499,970 (dhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “KRISTALINA.KH” sh.p.k** **NUIS K11501002D**

Vlera e ofertës pa tvsh = 9,687,916 (nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k** **NUIS L91418502J**

Vlera e ofertës pa tvsh = 9,000,000 (nëntë milion) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k** **NUIS J72124001N**

Vlera e ofertës pa tvsh = 6,707,260 (gjashtë milion e shtatëqind e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k** **NUIS L91418502J**

Për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e pikës 3.2 të **Seksionit 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike** së DST ku përcaktohet se: *Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë.*

Operatori ekonomik, ka paraqitur sigurimin e ofertës me periudhë vlefshmërie 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë duke mos e plotësuar këtë kriter. OE skualifikohet pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat për kualifikim.

- **Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k** **NUIS L52122014L**

Për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e pikës 3.2 të **Seksionit 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike** së DST ku përcaktohet se: *Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë.*  
Operatori ekonomik, ka paraqitur sigurimin e ofertës me periudhë vlefshmërie 150 (*njëqind e pesëdhjetë*) ditë duke mos e plotësuar këtë kriter. OE skualifikohet pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat për kualifikim
- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k NUIS J72124001N**

Për arsyet e mëposhtme:

“MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k.nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët për këto arsye:

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 pasi nuk arriti të argumentojë ofertën anomalisht të ulët , për shkak se dokumentacioni i paraqitur ka mangësi thelbësore në plotësimin e kushteve të kërkuara nga legjislacioni a) argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar; dhe b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

Në shkresën e paraqitur me objekt ”Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për sqarimin për procedurën e prokurimit me objekt Loti I ”Materiale kancelarie me bazë letre” operatori ekonomik ka deklaruar se (ekstrakt i deklaramentit)

a) shoqëria është një nga kompanitë kryesore në importimin dhe distribucionin e një larmishmërie produktesh, me një eksperiencë 10 vjeçare në sektorin e tregtimit të kancelarive të të gjitha llojeve si dhe produkteve objekt prokurimi.

Në lidhje me çmimet e ofertës së dorëzuar për procedurën e lartpërmendur, ju informojmë se çmimet janë marrë nga furnitorët tanë në bazë të raportit shumëvjeçarë dhe rritjes së volumit të blerjes nga viti në vit.....

b) kompania është lider në tregun shqiptar për tregtimin e artikujve të kancelarisë, letrës, tonerave dhe pajisjeve të ndryshme të zyrës me një përvojë mbi 20 vjeçare, me mundësi financiare të konsoliduara.....

Kompania jonë është distributor i autorizuar për shumë marka produktesh. Kjo na jep mundësinë të përfitojmë çmime shumë favorizuese. Me synimin për të fituar këtë procedure, kompania jonë ka ofertuar me një normë të ulët fitimi, gjë që shpjegon edhe vlerën e ulët të ofertës tonë. ....

Bashkëngjitur gjeni edhe disa vertetime realizimi kontratash dhe fatura të ngjashme, që tregojnë realizimin me sukses të tyre.

c) Konfirmojmë se artikujt e ofertuar nga kompania janë plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga ana e juaj në dokumentet e tenderit dhe të gjitha standardet ndërkombëtare të cilësisë.....

ç) Për t'iu konfirmuar që kompania janë plotëson të gjitha detyrimet ligjore, po ju paraqesim një vërtetim pagesës së rregullt të detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.....

Referuar kushteve e percaktuara ne Nenin 93 te LPP, operatori ekonomik ka patur detyrimin të argumentojë ofertën duke sqaruar cdo element të percaktuar nga kjo dispozite e ligjit e konkretisht për:

- a) argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

#### 1. Arsyetimi për mosargumentim e kushtit

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtim/argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar;

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik shprehet se çmimet e ofertës së dorëzuar për procedurën e lartpërmendur, janë marrë nga furnitorët në bazë të raportit shumëvjeçarë dhe rritjes së volumit të blerjes nga viti në vit. Çmimet janë më të favorshme si pasojë e bashkëpunimit afatgjatë me partnerët ndërkombëtarë dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi kompania favorizohet nga furnitorët duke marrë zbritje preferenciale për produktet e ndryshme, etj...

Në lidhje me këtë pjesë të argumentimit ekonomik të subjektit KVO konstaton se ky argumentim nuk qëndron pasi operatori nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo fakt (fatura apo kontrata bashkëpunimi me furnitorët) ku të evidentohet favorizimi apo zbritja preferenciale e pretenduar nga operatori ekonomik.

2. Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik shprehet se kompania është lider në tregun shqiptar për tregtimin e artikujve të

kancelarisë, letrës, tonerave dhe pajisjeve të ndryshme të zyrës me një përvojë mbi 20 vjeçare, me mundësi financiare të konsoliduara.....

Kompania jonë është distributor i autorizuar për shumë marka produktesh. Kjo na jep mundësinë të përfitojmë çmime shumë favorizuese. Me synimin për të fituar këtë procedurë, kompania jonë ka ofertuar me një normë të ulët fitimi, gjë që shpjegon edhe vlerën e ulët të ofertës tonë. Me çmime të ngjashme të ofertuara në këtë procedurë prokurimi, shoqëria jonë ka kuotuar, fituar dhe realizuar me sukses për 8 vjet prokurimet e përqendruara për tonera, letë dhe kancelari të zhvilluara nga Ministria e Brendshme, etj....

Bashkëngjitur gjeni edhe disa vertetime realizimi kontratash dhe fatura të ngjashme, që tregojnë realizimin me sukses të tyre.

Në lidhje me këtë pjesë të argumentimit ekonomik të subjektit KVO konstaton se ky argumentim nuk qëndron pasi përsëri operatori nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo fakt (fatura apo kontrata bashkëpunimi me furnitorët) nga të cilat ë evidentohet norma e ulët e fitimit e pretenduar nga operatori ekonomik.

Gjithashtu referuar kontratës nr. 801, datë 30.01.2024 me objekt “Blerje kancelari”, lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Kamëz, rezulton se artikujt në kontratën e sipërcituar janë të ndryshëm nga artikujt objekt prokurimi dhe në këto kushte nuk mund të evidentohet që çmimi i artikujve, paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën objekt prokurimi është i njëjtë me atë të realizuar nga operatori dhe të paraqitur për të argumentuar zgjidhjen teknike.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, të ndryshuar dhe arsyetimet e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k., me NUIS J72124001N.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si operator ekonomik i sukseshëm

• **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k**

**NUIS J62426002Q**

Vlera e ofertës pa tvsh = 9,097,759 (nëntë milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerejeve të Përqendruara sha brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO



JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO

JO